



**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT
DEPARTAMENTI I AKUAKULTURES DHE PESHKIMIT**



**MIRATOHET
DEKANI**

Prof. Dr. Ilir KRISTO

***Rregullore e Departamentit
të
Akuakultures dhe Peshkimit***

Qershor, 2021

Neni 1

Baza Ligjore

Rregullorja e Departamentit të Akuakulturës dhe Peshkimit (DAP) mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 41 datë 24.1.2018, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.329 datë 12/04/2017, Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë nr. 29 datë 10/09/2018, në Statutin e Universitetit, në Rregulloren e Studimeve Universitare e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe në Rregulloren e brendëshme të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM);

Neni 2

Objekti i Rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave standarde për programet e studimeve që zhvillohen në Departamentin e Akuakulturës dhe Peshkimit. Ajo është hartuar në përputhje me planet mësimore të programeve, por duke respektuar edhe lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik, të studentëve, si dhe legjislacionin në fuqi;

Neni 3

Efektet e Rregullores

Kjo Rregullore i shtrin efektet e saj mbi Departamentin e Akuakulturës dhe Peshkimit studentët dhe personelin akademik dhe jo-akademik të këtij departamenti.

Neni 4

Organizimi

Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore, ai përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplina mësimore respektive. Departamentit i Akuakulturës dhe Peshkimit ka për detyrë:

- Të përgjigjet për programet e studimit që ofron;
- Të nxisë, programojë, bashkërendojë, zhvillojë, organizojë dhe administrojë veprimtarinë e mësimdhënies dhe ato kërkimore-shkencore;
- Të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme me karakter kërkimor-shkencor – grupet kërkimore-shkencore (GMK);
- Të propozojë programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë;
- Të propozojë kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore;
- Të ofrojë shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të UBT-së.

Përgjegjësi i departamentit është autoriteti drejtues akademik për departamentin, si dhe e përfaqëson atë.

Departamenti përbëhet nga 2 (dy) grupe mësimore – kërkimore si më poshtë vijon:

- ❖ Grupi mësimor – kërkimor i “Akuakulturës”
- ❖ Grupi mësimor – kërkimor i “Peshkimit dhe Hidrobiologjisë”

Neni 5

Përgjegjësi i Departamentit

Është autoriteti drejtues akademik i departamentit dhe e përfaqëson atë.

Ai **zgjidhet** nga asambleja e personelit akademik të departamentit, është personel akademik i kategorisë “Profesor” (Profesor Dr. Ose Prof. Asoc. Dr) ose ka gradën shkencore “Doktor”

(PhD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Drejtuesi i departamentit emërohet nga Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit.

- Mund të shërbejë në detyrë për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
- Drejtuesi i departamentit i propozon administratorit të fakultetit shkarkimin e administratorit të departamentit.
- Drejton të gjithë veprimtarinë mësimore dhe shkencore në departament.
- Garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta, të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve të departamentit.
- Përgatit dhe propozon kurrikulat e studimeve të departamentit, drejtime e profile të reja studimesh, projekte për programe të studimeve dhe të kërkimit shkencor etj.
- I propozon Dekanit për miratim përgjegjësit e grupeve mësimore kërkimore të përzgjedhur **me konkurim**.
- Propozon kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për të gjitha ciklet e studimeve.
- Organizon procedurat e përzgjedhjes dhe të regjistrimit të kandidatëve të rinj, të studentëve të ciklit të dytë etj.
- Thërret dhe kryeson mbledhjet e departamentit.
- Realizon bashkëveprimin ndërmjet grupeve mësimore -kërkimore.
- Miraton programet mësimore të moduleve.
- Miraton komisionet e provimeve universitare.
- Informohet nga të gjithë anëtarët e departamentit rreth veprimtarive që ata kryejnë, si dhe ushtron kontroll rreth kësaj veprimtarie.
- Përfaqëson departamentin në marrëdhëniet e bashkëpunimit me persona dhe institucione të vendit dhe të huaja.
- Propozon përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave, si dhe formulon tezat e provimeve të formimit.

Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të departamentit, ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

Neni 6

Organizimi i Vitit Akademik

Studimet në Departamentin e Akuakulturës dhe Peshkimit zhvillohen me bazë vitin akademik. Ministri i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall datën e fillimit të vitit akademik. Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka 15 javë. Koha e fillimit, mbarimit, sezonet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në strukturën e vitit akademik të miratuar çdo vit, i cili do të bazohet në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Arsimit.

Neni 7

Format dhe Ciklet e Studimeve

Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit ofron studime me kohë të plotë dhe në programe studimi të ciklit të parë (**Bachelor**), të ciklit të dytë (**Master i Shkencave dhe Master Profesional**). Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit nuk ka ofruar studime në programin e ciklit të tretë "**Doktoraturë**", por është pjesë e aplikimit për hapje të programit të ciklit të tretë në nivel fakulteti në "**Shkenca Bujqesore**".

Neni 8

Emërtimi i programeve të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në DAP

Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit ofron programe studimi të ciklit të parë "Bachelor", në:

- "Inxhinier Agrar" drejtimi "Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi" – vetëm për studentët e vitit të fundit *Bachelor*;
- "Inxhinier Agrar" drejtimi "Biologji Marine dhe Akuakulturë".

Neni 9

Pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në DAP

Studimet në Departamentin e Akuakulturës dhe Peshkimit mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnikë jashtë kufijve shtetërorë si dhe nga çdo shtetas i huaj, në bazë të kritereve të përcaktuara nga MASR, Statuti dhe rregullorja e studimeve të UBT-së.

Pranimi në programet e studimit "Bachelor" të **DAP**, bëhet sipas udhëzimeve dhe kuotave të

përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës.

Në programet e studimit të ciklit të parë të **DAE** pranohen kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë përfunduar jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare. Pranohen edhe kandidatët që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. Për këtë kategori kërkohet që të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar prej tyre në vendin e huaj nga komisioni përkatës në MASR.

Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm si më sipër, si dhe që plotëson:

- ✓ **Kriterin e meritës** (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ✓ **Kriterin e rëndësisë** (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në **DAP**) sipas përcaktimeve të departamenteve;
- ✓ **Notës mesatare të lëndës me zgjedhje në fushën e biologjisë;**
- ✓ **Kuotave të paracaktuara.**

Neni 10

Regjistrimi i Studentëve

Kandidatët fitues të shpallur, fitojnë statusin e studentit dhe kanë të drejtë të ndjekin studimet në vitin akademik përkatës, nëse regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit, pasi kanë dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm juridik, brenda afateve kohore të përcaktuara dhe të shpallura paraprakisht (në udhëzimet përkatëse të MASR) dhe mandat pagesën e tarifës së regjistrimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit.

Studentët pasi regjistrohen në sekretarinë mësimore, kryejnë edhe regjistrimin në sistemin elektronik të sekretarisë (ESSE 3), ku pajisen me *user name* personal dhe *password*, që do t'u shërbejnë atyre për të parë të gjithë informacionin në lidhje me procesin mësimor dhe rezultatet e arritura.

Studentët e regjistruar pajisen me librezë studenti. Studenti duhet të paguaj tarifën vjetore të shkollimit për vitin përkatës akademik para fillimit të sezonit të provimeve të dimrit. Në rast mospagesë, ai humbet të drejtën për të hyrë në provime.

Studenti e humbet statusin e tij për marrjen e diplomës, me largimin vullnetar të tij pa përfunduar studimet ose me përjashtimin e tij nga universiteti.

Neni 11

Kohëzgjatja e Studimeve

Kohëzgjatja normale e studimeve në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” është **3 (tre) vite** akademike.

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se **dyfishi i kohëzgjatjes normale** të tij, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Në këtë rast ai duhet **të shlyejë detyrimet sipas planit mësimor** dhe paguajë tarifat përkatëse.

Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Programet e studimit janë të organizuar në module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Studenti në përfundim të programit të studimit duhet të grumbullojë 180 kredite.

Neni 12

Kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe të diplomimit

Viti akademik mbyllet në përfundim të sezonit të vjeshtës.

Studenti i vitit të parë *Bachelor* kalon në vitin e dytë nëse ka grumbulluar minimumi **25 kredite**.

Studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ka grumbulluar minimumi **80 kredite**, nga të cilat jo më pak se **50 kredite** nga viti i parë.

Studenti i vitit të tretë me kohë të plotë që në përfundim të studimeve ka grumbulluar **180 kredite**, ka të drejtë të paraqitet në provimin e formimit (sezonin e diplomimit në muajin korrik).

Studenti i vitit të parë dhe vitit të dytë që nuk plotëson kriteret për të kaluar në vitin pasardhës **shpallet përsëritës** dhe ka këto të drejta e detyrime:

- ✓ I njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin ose vitet paraardhës kur programet e moduleve janë të pranueshme për vitin në vazhdim;

- ✓ Të paraqitet në sezonet e rregullta të provimeve (sezoni i dimrit, sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të vitit që është shpallur përsëritës, për modulet që është vlerësuar **me notë negative** ose **nuk u paraqit**;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë modulet për të cilat ka **si detyrim frekuentimin** e vitit që është shpallur përsëritës dhe të paraqitet në sezonet e rregullta të provimeve (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të këtij viti;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë **modulet e reja** për shkak të ndryshimit të kurrikulës së programit të studimit, **të vitit që është shpallur përsëritës** (jo për vitet e mëparshme) dhe të paraqitet në sezonet e rregullta të provimeve (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të këtij viti;
- ✓ Duhet të paguajë tarifën e shkollimit.

Studenti i vitit të tretë me kohë të plotë që nuk plotëson kriteret për t'u paraqitur në provimin e formimit pasi ka detyrime të pashlyera (vetëm module të vlerësuara **me notë negative** ose **nuk u paraqit**), ka këto të drejta e detyrime:

- ✓ Të shlyejë detyrimet e prapambetura **në sezonin plotësues** (muaji janar) dhe **sezonin e rregullt të dimrit** të vitit pasardhës dhe të paraqitet në provimin e formimit (*sezoni i diplomimit në muajin mars*);
- ✓ Nëse nuk arrin të shlyejë detyrimet në afatet e përcaktuara mund t'i shlyejë ato **në sezonin plotësues** (muaji prill) dhe **sezonin e rregullt të verës** të po atij viti dhe të paraqitet në provimin e formimit (sezoni i diplomimit në muajin korrik).
- ✓ Duhet të paguajë kreditet për modulet e pashlyera.

Studenti i vitit të tretë me kohë të plotë që nuk plotëson kriteret për t'u paraqitur në provimin e formimit pasi ka detyrime të pashlyera (module **me notë negative** ose **nuk u paraqit** dhe të paktën një modul **me detyrim frekuentimin**) **shpallet përsëritës** dhe ka këto të drejta e detyrime:

- ✓ I njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin ose vitet paraardhëse kur programet e moduleve janë të pranueshme për vitin në vazhdim;
- ✓ Të paraqitet në sezonet plotësuese të provimeve (janar dhe prill), sezonet e rregullta (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të vitit që është shpallur përsëritës (viti i tretë), për modulet që është vlerësuar **me notë negative** ose **nuk u paraqit**;

- ✓ Është i detyruar të frekuentojë modulin/et për të cilat ka **si detyrim frekuentimin**;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë **modulin/et e reja** të vitit që është shpallur përsëritës (viti i tretë), për shkak të ndryshimit të kurrikulës së programit të studimit (por jo për vitet e mëparshme);
- ✓ Duhet të paguajë tarifën e shkollimit.

Neni 13

Organizimi dhe Vlerësimi i Praktikave Profesionale

Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të tretë të studimeve. Kohëzgjatja dhe afati i kryerjes përcaktohen në strukturën e vitit akademik.

Studenti merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet për realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale në terren. Departamenti mban përgjegjësi për evidentimin e kompanive ose institucioneve të mundshme për kryerjen e praktikës profesionale, si dhe krijimin e lidhjeve me to. Studenti mund t'i propozojë departamentit vendin ku mund të kryejë praktikën profesionale.

Praktikat profesionale zhvillohen në institucione ose kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti.

Departamenti bën ndarjen e studentëve nëpër kompani ose institucione pritëse, duke respektuar edhe dëshirat e tyre.

Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës profesionale. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit pritës. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, punonjësi mësimor që e drejton atë, mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet.

Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer, e cila vlerësohet në datën e caktuar nga departamenti dhe komisioni i ngritur prej tij, pasi merr në konsideratë edhe vlerësimin e kompanisë (qendrës) ku është kryer praktika.

Vlerësimi i praktikës profesionale në procesverbal bëhet me **Notë**. Nëse studenti nuk paraqitet në datën e caktuar, në procesverbal shënohet **“Nuk u paraqit”**

Nëse studenti në praktikën profesionale vlerësohet me **“Nuk fiton”** shpallet **përsëritës** dhe duhet ta shlyejë atë në vitin akademikë pasardhës.

Nëse studenti në praktikën profesionale vlerësohet me **“Nuk u paraqit”** duhet ta shlyejë atë në sezonin e vjeshtës të vitit të tretë ose në datat e provimeve të shpallura para sezonit të diplomimit.

Neni 14

Diplomimi i studentëve të programit të ciklit të parë "Bachelor"

Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve "Bachelor" diplomohen me **provim të përgjithshëm përfundimtar**.

Organizohen **dy sezone** për provimin e përgjithshëm përfundimtar (muaji korrik dhe muaji mars). Datat e zhvillimit të provimeve sipas sezoneve përkatëse, përcaktohen nga Dekani i Fakultetit.

Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i departamentit, miratohet nga përgjegjësi i departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Programi shpallet, në faqen e webit të FBM-së, dhe u bëhet i ditur studentëve.

Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit përgjithësisht është përgjegjësi i departamentit. Ai respekton në çdo rast, për secilin student procedurën dhe rregullat përkatëse të vendosura nga Dekanati.

Teza e provimit përmban pyetje nga fushat që përfshihen në programin e provimit. Tezat e provimit të formimit hartohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe, firmosen nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohen nga Dekani i fakultetit.

Provimi organizohet me gojë. Rezultatet e provimit të formimit u jepen studentëve në fund të çdo dite provimi. Komisioni i provimit merr në shqyrtim çdo ankesë të studentëve, përpara se të marrë vendimin përfundimtar. Nëse gjatë ballafaqimit konstatohet se është bërë gabim gjatë vlerësimit, bëhet ndryshimi i vlerësimit.

Në përfundim të procesit të provimit, komisioni hedh rezultatet në sistem, printon procesverbalin, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit, si dhe më pas nga personat e tjerë përgjegjës.

Neni 15

Riprovimet në sezonin e vjeshtës dhe sezonet plotësuese

Në sezonin e vjeshtës (muaji shtator) paraqiten për shlyerjen e provimeve vetëm studentët e rregullt që kanë rezultuar të pasuksesshëm në dy sezonet e rregullta të vitit akademik që kanë frekuentuar. Sezoni i vjeshtës, për studentët e vitit të fundit Bachelor (viti i tretë), zhvillohet në *në muajin shtator*.

Numri i provimeve të mundshme për t'u shlyer në këtë sezon është sa gjysma e provimeve të vitit akademik të frekuentuar. Kur numri i moduleve është tek, numri i provimeve është **50% plus 1**.

Për studentët e rregullt, të vitit të dytë, vitit të tretë Bachelor, që në përfundim të sezonit të vjeshtës rezultojnë me module të mbartuara (nga viti i parë dhe i dytë), shlyerja e tyre bëhet në *sezonet plotësuese (janar dhe prill)* të vitit akademik pasardhës.

Studentët e vitit të fundit, (viti i tretë) që në përfundim të provimeve sezonit të fundit rezultojnë me 3(tre) module të pashlyera, kanë të drejtë t'i shlyejnë ato *dy javë para fillimit të sezonit të diplomimit*.

Neni 16

Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"

Programi i studimit "Master i Shkencave" në Departamentin e Akuakulturës dhe Peshkimit pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën e Inxhinierisë së Akuakultures.

Programi i studimit "Master i Shkencave" është i organizuar me **120 kredite** formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje **dy vite** akademike.

Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit "Master i Shkencave" është gjuha shqipe/angleze.

Neni 17

Emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"

Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit ofron program studimi të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në:

- "Akuakulturë".

Neni 18

Pranimi dhe rregjistrimi në programin e ciklit të dytë të studimeve

Kriteret e aplikimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve "Master i Shkencave" janë si më poshtë: Të jenë diplomuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesëshme në një nga programet e studimit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të listuara më poshtë:

- ✓ Universiteti Bujqësor i Tiranës: Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Fakultetet e tjera (Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Fakulteti i Mjeksisë Veterinare, Fakulteti i Bioteknologjisë & Ushqimit, Fakulteti i Pyjeve);
- ✓ Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe programe të tjera të ngjashme.
- ✓ Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Tiranës dhe universitetet e rretheve.
- ✓ Universitete private me programe të ngjashme dhe të akredituara.
- ✓ Universitete analoge nga trojet shqiptare.

Përfitojnë të drejtën për të vazhduar studimet e ciklit të dytë studentët që kanë diplomë Bachelor/DNP, studentët që kanë përfunduar studimet me sistemin e vjetër (4-4.5 vjet) ose diploma Master Nivelit të Parë/ Master Profesional.

Përzgjedhja e studentëve bëhet sipas kriterit të meritës nga lart poshtë brenda kuotave të miratuara bazuar në kriteret e mëposhtme:

- ✓ **kriteri i meritës** (nota mesatare e studimeve në bachelor)
- ✓ **kriteri i rëndësisë** (koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushën dhe programin e studimit të **DAP**).
- ✓ **kuotat e paracaktuar nga ana e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit.**

Përzgjedhja e kandidatëve fitues (**F**) në programin e ciklit të dytë: "Master i Shkencave" do të jetë rezultat i produktit:

$$F = N \times K$$

Ku:

N – Nota mesatare në bachelor

K – Koeficienti i rëndësisë, i cili përcaktohet sipas profilit të programit të studimit që aplikohet si më poshtë:

- *Kandidatët e diplomuar në bujqësi dhe mjedis, në të njëjtin profil studimi me studimet e ciklit të parë (Bachelor), koeficienti 1.00*
- *Kandidatët e diplomuar në FBM të UBT, jashtë profileve të studimit me studimet e ciklit të parë (Bachelor) koeficienti 0.95*
- *Kandidatët e diplomuar në UBT jashtë FBM, jashtë profileve të studimit me studimet e ciklit të parë (Bachelor), koeficienti 0,9*
- *Kandidatët e diplomuar jashtë UBT-së, brenda profileve të studimit me studimet e ciklit të parë (Bachelor), koeficienti 0,9*
- *Kandidatët e diplomuar jashtë UBT-së, jashtë profileve të studimit me studimet e ciklit të parë (Bachelor), koeficienti 0,85.*

Neni 19

Kohëzgjatja e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave"

Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" zhvillohet me kohë të plotë.

Kohëzgjatja **normale** e studimeve është **dy vite akademike**. Kohëzgjatja **maksimale** nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet;

Studenti mund të vijojë pjesëmarrjen në programin "Master i Shkencave" edhe mbi kohën normale të studimeve. Në këtë rast ai duhet të shlyejë detyrimet sipas planit mësimor dhe paguajë tarifat përkatëse.

Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të departamentit që kërkon të aplikojë.

Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" është i organizuar në module dhe i vlerësuar me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi "Master i Shkencave" me kohë të plotë është 60 kredite. Studenti në fund të këtij

programi grumbullon 120 kredite.

Neni 20

Kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe të diplomimit

Viti akademik mbyllet në përfundim të sezonit të vjeshtës. Studenti i vitit të parë "Master i Shkencave" kalon në vitin e dytë nëse ka grumbulluar minimumi **30 kredite**.

Studenti i vitit të dytë me kohë të plotë që në përfundim të studimeve ka grumbulluar **120 kredite**, ka të drejtë të paraqitet në sezonin e rregullt të diplomimit (muaji shtator ose tetor).

Studenti i vitit të parë "Master i Shkencave" që nuk plotëson kriteret për të kaluar në vitin pasardhës **shpallet përsëritës** dhe ka këto të drejta e detyrime:

- ✓ I njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin ose vitet pararendëse, kur programet e moduleve janë të pranueshme për vitin në vazhdim;
- ✓ Të paraqitet në sezonet e rregullta të provimeve (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të vitit që është shpallur përsëritës, për modulet që është vlerësuar **me notë negative** ose **nuk u paraqit**;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë modulet për të cilat ka **si detyrim frekuentimin** e vitit që është shpallur përsëritës dhe të paraqitet në sezonet e rregullta të provimeve (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të këtij viti;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë **modulet e reja** për shkak të ndryshimit të kurikulës së programit të studimit, **të vitit që është shpallur përsëritës** dhe të paraqitet në sezonet e rregullta të provimeve (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të këtij viti;
- ✓ Duhet të paguajë tarifën e shkollimit.

Studenti i programit mësimor "Master i Shkencave" që nuk plotëson kriteret për tu paraqitur në mbrojtjen e diplomës pasi ka detyrime të pashlyera (vetëm module të vlerësuara **me notë negative** ose **nuk u paraqit**), ka këto të drejta e detyrime:

- ✓ Të shlyejë detyrimet e prapambetura **në sezonet e rregullta** (dimrit dhe verës) **sezonet plotësuese** (muaji janar dhe muaji prill) të vitit pasardhës akademik dhe të paraqitet në datat e shpallura jashtë sezonit të rregullt të diplomimit (çdo dy muaj);
- ✓ Duhet të paguajë kreditet për modulet e pashlyera.

Studenti i vitit të dytë "Master i Shkencave" që nuk plotëson kriteret për tu paraqitur në

mbrojtjen e tezës së diplomës pasi ka detyrime të pashlyera module **me notë negative** ose **nuk u paraqit** dhe të paktën një modul **me detyrim frekuentimin** shpallet **përsëritës** dhe ka këto të drejta e detyrime:

- ✓ I njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin ose vitet pararendese kur programet e moduleve janë të pranueshme për vitin në vazhdim;
- ✓ Të paraqitet në sezonet plotësuese të provimeve (janar dhe prill), sezonet e rregullta (sezoni i dimrit dhe sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të vitit që është shpallur përsëritës (viti i tretë), për modulet që është vlerësuar **me notë negative** ose **nuk u paraqit**;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë modulën/et për të cilat ka **si detyrim frekuentimin**;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë **modulën/et e reja** të vitit që është shpallur përsëritës, për shkak të ndryshimit të kurrikulës së programit të studimit (por jo për vitin e mëparshëm);
- ✓ Duhet të paguajë tarifën e shkollimit.

Neni 21

Diplomimi i studentëve të programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave"

Studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma "Master i Shkencave" në fushën e Inxhinierisë së Akuakultures. Punimi i diplomës është një punim i pavarur shkencor i studentit.

Departamenti harton listën e studentëve dhe udhëheqësin shkencor dhe ja paraqet për miratim Dekanit të FBM-së. Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e përgatitjes së një punimi diplome të nivelit të dytë "Master i Shkencave". Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studenti dhe pedagogu. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe **lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë**. Sezoni i rregullt i diplomimit të studentëve që diplomohen në ciklin e dytë të studimeve "Master të Shkencave", organizohet në **muajin shtator ose tetor**. Datat e mbrojtjes së punimeve të diplomës përcaktohen nga Dekani

i fakultetit.

Për studentët të cilët **nuk rezultojnë të suksesshëm** (janë vlerësuar negativisht) në mbrojtjen e punimit të diplomimit në sezonin e rregullt, riprovimi bëhet **pas 6 muajsh**.

Për studentët të cilët **nuk paraqiten** në sezonin e rregullt të shpallur nga fakulteti dhe që përmbushin të gjitha detyrimet që përmban programi i studimit, përfshirë edhe provimin me teste ndërkombëtare të gjuhës angleze, gjatë vitit akademik pasardhës, mbrojtja e punimit të diplomës bëhet sipas një grafiku **çdo dy muaj**.

Neni 22

Riprovimet në sezonin e vjeshtës dhe sezonet plotësuese

Në sezonin e vjeshtës (muaji shtator) paraqiten për shlyerjen e provimeve vetëm studentët e rregullt që kanë rezultuar të pasuksesshëm në dy sezonet e rregullta të vitit akademik që kanë frekuentuar.

Numri i provimeve të mundshme për t'u shlyer në këtë sezon është sa gjysma e provimeve të vitit akademik të frekuentuar. Kur numri i moduleve është tek, numri i provimeve është **50% plus 1**.

Për studentët e rregullt, të vitit të parë që në përfundim të sezonit të vjeshtës rezultojnë me module të mbartuara, shlyerja e tyre bëhet në **sezonet plotësuese (janar dhe prill)** të vitit akademik pasardhës.

Studentët e vitit të fundit, (viti i dytë) që në përfundim të provimeve sezonit të fundit rezultojnë me **2 (dy) module** të pashlyera, kanë të drejtë t'i shlyejë ato **1 javë** para fillimit të sezonit të diplomimit.

Neni 23

Përgatitja e diplomës

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë "*Master i Shkencave*" në programin e studimit të kryer, të firmosur nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i UBT-së, e cila është dokument zyrtar.

Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar.

Neni 24

Programi i ciklit të dytë "Master Profesional"

Programi i studimit "Master Profesional" pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Programi i studimit "Master Profesional" është i organizuara me **60 kredite** formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje **një vit** akademik.

Neni 25

Emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në

Departamentin e Akuakulturës dhe Peshkimit

Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit ofron program studimi të ciklit të dytë "Master Profesional" në fushën e:

- "Teknologjitë e Prodhimit në Akuakulturë"

Neni 26

Pranimi dhe regjistrimi në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional"

Kandidatët që aplikojnë për në ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional" duhet të jenë diplomuar me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në një nga programet e studimit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të listuara si më poshtë:

- ✓ Universiteti Bujqësor i Tiranës: Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit dhe fakultetet e tjera (Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Fakulteti i Pyjeve);
- ✓ Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe programe të tjera të ngjashme.
- ✓ Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Tiranës dhe universitetet e rretheve.
- ✓ Universitete private me programe të ngjashme dhe të akredituara.
- ✓ Universitete analoge nga trojet shqiptare.

Përfitojnë të drejtën për të vazhduar studimet e ciklit të dytë studentët që kanë diplomë Bachelor/ DNP, studentët që kanë përfunduar studimet me sistemin e vjetër (4-4.5 vjet) ose diploma Master Nivelit të Parë/ Master Profesional. Përzgjedhja e studentëve të bëhet sipas kriterit të meritës nga lartë poshtë brenda kuotave të miratuara.

Kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes së studentëve në ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional", janë si më poshtë:

- ✓ **kriteri i meritës** (nota mesatare e studimeve në bachelor)
- ✓ **kriteri i rëndësisë** (koeficienti i profilit të studimeve Bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të).
- ✓ **kuota e paracaktuar.**

Përzgjedhja e kandidatëve fitues (**F**) në programin e ciklit të dytë: "**Master Profesional**" do të jetë rezultat i produktit:

$$F = N \times K$$

Ku:

N – Nota mesatare në *Bachelor*

K – Koeficienti i rëndësisë, i cili përcaktohet sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet si më poshtë:

- Kandidatët e diplomuar në bujqësi dhe mjedis, **në të njejtin profil studimi** me studimet e ciklit të parë *Bachelor*, koeficienti **1.00**
- Kandidatët e diplomuar në FBM të UBT, **jashtë profileve të studimit** me studimet e ciklit të parë *Bachelor* koeficienti **0.95**
- Kandidatët e diplomuar në UBT jashtë FBM, **jashtë profileve të studimit** me studimet e ciklit të parë *Bachelor*, koeficienti **0,9**
- Kandidatët e diplomuar jashtë UBT-së, **brenda profileve të studimit** me studimet e ciklit të parë *Bachelor*, koeficienti **0,9**
- Kandidatët e diplomuar jashtë UBT-së, **jashtë profileve të studimit** me studimet e ciklit të parë (*Bachelor*), koeficienti **0,85**.

Neni 27

Kohëzgjatja e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional"

Programi i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" zhvillohet me kohë të plotë. Kohëzgjatja **normale** e studimeve është një vit akademik (60 kredite). Kohëzgjatja **maksimale** nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet;

Studenti mund të vijojë pjesëmarrjen në programin "Master Profesional" edhe mbi kohën normale të studimeve. Në këtë rast ai duhet të shlyejë detyrimet sipas planit mësimor dhe paguajë tarifat përkatëse. Studenti që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të departamentit që kërkon të aplikojë. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të departamentit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e tij. Programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" janë organizuar në module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi "Master Profesional" në **DAP** me kohë të plotë është 60 kredite. Studenti në fund të këtij programi grumbullon 60 kredite.

Neni 28

Kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe të diplomimit

Viti akademik mbyllet në përfundim të sezonit të vjeshtës. Studenti me kohë të plotë që në përfundim të studimeve ka grumbulluar **60 kredite**, ka të drejtë të paraqitet në sezonin e rregullt të diplomimit (muaji shtator ose tetor).

Studenti "Master Profesional" që nuk plotëson kriteret për tu paraqitur në provimin e formimit pasi ka detyrime të pashlyera (vetëm module të vlerësuara **me notë negative** ose **nuk u paraqit**), ka këto të drejta e detyrime:

- ✓ Të shlyejë detyrimet e prapambetura **në sezonet e rregullta** (dimrit dhe verës) **sezonet plotësuese** (muaji janar dhe muaji prill) të vitit pasardhës akademik dhe të paraqitet në datat e shpallura jashtë sezonit të rregullt të diplomimit (çdo dy muaj);

- ✓ Duhet të paguajë kreditet për modulet e pashlyera.

Studenti "Master Profesional" që nuk plotëson kriteret për tu paraqitur në provimin e formimit pasi ka detyrime të pashlyera (module **me notë negative** ose **nuk u paraqit** dhe të paktën një modul **me detyrim frekuentimin**) *shpallet përsëritës* dhe ka këto të drejta e detyrime:

- ✓ I njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin ose vitet paraardhës kur programet e moduleve janë të pranueshme për vitin në vazhdim;
- ✓ Të paraqitet në sezonet plotësuese të provimeve (janar dhe prill), sezonet e rregullta (sezoni i dimrit, sezoni i verës) dhe sezonin e vjeshtës të vitit që është shpallur përsëritës (viti i tretë), për modulet që është vlerësuar **me notë negative** ose **nuk u paraqit**;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë modulën/et për të cilat ka **si detyrim frekuentimin**;
- ✓ Është i detyruar të frekuentojë **modulën/et e reja** të vitit që është shpallur përsëritës (viti i tretë), për shkak të ndryshimit të kurikulës së programit të studimit (por jo për vitet e mëparshme);
- ✓ Duhet të paguajë tarifën e shkollimit.

Neni 29

Organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale

Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të studimeve, sipas kohëzgjatjes së programit të studimit. Kohëzgjatja dhe afati i kryerjes përcaktohen në strukturën e vitit akademik. Studenti merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet për realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale në terren. Departamenti mban përgjegjësi për evidentimin e kompanive/institucioneve të mundshme për kryerjen e praktikës profesionale, si dhe krijimin e lidhjeve me to. Studenti mund t'i propozojë departamentit vendin ku mund të kryejë praktikën profesionale.

Praktikat profesionale zhvillohen në institucione/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. Departamenti bën ndarjen e studentëve nëpër kompani/institucione pritëse, duke respektuar edhe dëshirat e tyre. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës profesionale. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit pritës. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, punonjësi mësimor që e drejton atë, mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet.

Në përfundim të praktikës profesionale, studentit përgatit një relacion për punën e kryer, e cila

vlerësohet në datën e caktuar nga Departamenti dhe komisioni i ngritur prej tij, pasi merr në konsideratë edhe vlerësimin e kompanisë (qendrës) ku është kryer praktika.

Vlerësimi i praktikës profesionale në procesverbal bëhet me **Notë**. Nëse studenti nuk paraqitet në datën e caktuar, në procesverbal shënohet **“Nuk u paraqit”**. Nëse studenti në praktikën profesionale vlerësohet me **“Nuk u paraqit”** duhet ta shlyejë atë në sezonin e vjeshtës ose në datat e provimeve të shpallura para sezonit të diplomimit.

Nëse studenti në praktikën profesionale vlerësohet me **“Nuk fiton”** shpallet **përsëritës** dhe duhet ta shlyejë atë në vitin akademik pasardhës.

Neni 30

Diplomimi i studentëve të programit të ciklit të dytë "Master Profesional"

Studimet e ciklit të dytë “Master Profesional” përmbyllen me provim përfundimtar formimi dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master Profesional” në:

- ✓ “Teknologjitë e Prodhimit në Akuakulturë”;

Fakulteti organizon **dy sezone** për provimin e përgjithshëm përfundimtar (muaj korrik dhe muaji mars). Datat e zhvillimit të provimeve sipas sezoneve përkatëse, përcaktohen nga Dekani i fakultetit.

Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Programi shpallet, në website-n e FBM-së, dhe u bëhet i ditur studentëve, sipas programit të studimit.

Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit përgjithësisht është Përgjegjësi i Departamentit. Ai respekton në çdo rast, për secilin student procedurën dhe rregullat përkatëse të vendosura nga Dekanati.

Teza e provimit përmban pyetje nga fushat që përfshihen në programin e provimit. Tezat e provimit të formimit hartohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe, firmosen nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit.

Provimi organizohet me gojë. Rezultatet e provimit të formimit u jepen studentëve në fund të çdo

dite provimi. Komisioni i provimit merr në shqyrtim çdo ankesë të studentëve përpara se të marrë vendimin përfundimtar. Nëse gjatë ballafaqimit konstatohet se është bërë gabim gjatë vlerësimit, bëhet ndryshimi i vlerësimit.

Në përfundim të procesit të provimit, komisioni hedh rezultatet në sistem, printon procesverbalin i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit, si dhe më pas nga personat e tjerë përgjegjës.

Neni 31

Riprovimet në sezonin e vjeshtës dhe sezonet plotësuese

Në sezonin e vjeshtës (muaji shtator) paraqiten për shlyerjen e provimeve vetëm studentët e rregullt që kanë rezultuar të pasuksesshëm në dy sezonet e rregullta të vitit akademik që kanë frekuentuar.

Numri i provimeve të mundshme për t'u shlyer në këtë sezon është sa gjysma e provimeve të vitit akademik të frekuentuar. Kur numri i moduleve është tek, numri i provimeve provimeve është **50% plus 1**.

Studentët që në përfundim të provimeve sezonit të fundit rezultojnë me **2(dy) module** të pashlyera, kanë të drejtë t'i shlyejë ato **1 javë** para fillimit të sezonit të diplomimit.

Neni 32

Përgatitja e diplomës

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë "Master Profesional" në programin e studimit të kryer, të firmosur nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i UBT-së, e cila është dokument zyrtar.

Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar (shih rregulloren e UBT-së).

Neni 33

Programet e Ciklit të Tretë të Studimeve

Studimet e doktoratës kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”. Fakulteti vendos kritere për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor. Këto programe rregullohen me rregullore të veçanta.

Neni 34

Dokumentacioni i programeve të studimit

Organizimi i një programi studimi mbështetet në hartimin e dokumentacionit themelor të tij që është:

- ✓ Kurrikula e studimeve;
- ✓ Plani mësimor;
- ✓ Programet mësimore të moduleve përbërëse;
- ✓ Rregullorja e programit të studimit.

Neni 35

Kurrikulat e studimeve

Kurrikula e studimeve e një programi studimi pasqyron strukturën e moduleve sipas viteve mësimore (module të formimit të përgjithshëm dhe të specialitetit), raportet e orëve mësimore (leksione dhe seminare) dhe kreditet për çdo modul.

Kurrikula e studimeve hartohet nga departamenti dhe miratohen nga Dekanati i Fakultetit dhe Senati i UBT-së.

Në fillim të çdo viti akademik, departamenti, bazuar në kurrikulën përkatëse, harton planet mësimore, të cilat miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit.

Në përshtatje me kurrikulën e çdo departamenti, studenti është i detyruar të zgjedhë një numër të

caktuar *modulesh me zgjedhje*.

Për çdo fushë diplomimi studentit i krijohet hapësirë e mjaftueshme për thellimin e dijeve ose specializimin e tij të ngushtë në fusha ku ai shpreh interes. Kjo realizohet si nëpërmjet tezës së diplomës, ashtu dhe shfrytëzimit të të drejtës për të zgjedhur një numër modulesh, sipas përcaktimeve në kurrikulat e çdo departamenti si edhe në përputhje me kërkesat e cikleve të studimeve universitare.

Neni 36

Plani mësimor

Plani mësimor buron nga kurrikula e studimeve dhe pasqyron periudhën kohore (vitin akademik) të zhvillimit të secilit prej modulevetë programit të studimit.

Plani mësimor i një programi studimi përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilin paraqiten elementët e mëposhtëm:

- ✓ Emërtimi i moduleve që përbëjnë programin e studimit të çdo kursi, të grupuara dhe të renditura në semestra;
- ✓ Numrin e krediteve për çdo modul dhe raportin e orëve (leksione dhe seminare);
- ✓ Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, projekt kursi, detyrë kursi, detyrë kontrolli, laboratore);
- ✓ Periudha dhe mënyra e kontrollit të dijeve të çdo moduli (semestri, provim ose kolokium);
- ✓ Mënyra e zhvillimit të provimit final për çdo modul (provim me gojë, me shkrim, me gojë dhe me shkrim);

Plani mësimor hartohet nga Përgjegjësi i departamentit dhe miratohet nga Dekani i fakultetit dhe Rektori i UBT-së.

Neni 37

Programi mësimor i modulit (syllabusi)

Programi mësimor i modulit (syllabusi) hartohet për çdo modul që përmban plani mësimor.

Në programin mësimor të modulit jepet në formë të përmbledhur struktura e modulit sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor (leksione dhe seminare).

Programi i modulit jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulin, kursin dhe semestrin kur zhvillohet, karakterin e modulit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; peshën e tij në ECTS; objektivat e modulit; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën. Pjesë e programit të modulit është edhe plani kalendar për çdo vit akademik;

Programi mësimor i modulit hartohet nga titullari i modulit, ose grup lektorësh, konsultohet me departamentin miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe Dekani i fakultetit.

Neni 38

Rregullorja programit të studimit

Çdo program studimi ka rregulloren e tij mësimore. Rregullorja mësimore e programit të studimit është pjesë e rëndësishme e dokumentacionit për hapjen e një programi dhe hartohet nga departamenti përgjegjës për programin e studimit, vlerësohet në dekanatin e fakultetit dhe miratohet në Senatin Akademik, së bashku me programin përkatës të studimit.

Rregullorja mësimore e programit të studimit, si bashkëshoqëruese e tij, është objekt rishikimi periodik. Rishikimi bëhet para fillimit të vitit të ri akademik dhe synon të korrigjohen problemet që janë ndeshur gjatë procesit mësimor, të përmirësohen dhe përditësohen elementë të ndryshëm të programit të studimit. Departamenti është përgjegjës për rishikimin ose përmirësimin e rregullores mësimore të programit të studimit në përputhje të plotë me këtë rregullore.

Neni 39

Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të **mësimdhënies, mësimnxënies** dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve, dhe rregulloren mësimore të programit të studimit.

Format e mësimit teorik dhe praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. Në përfundim të secilit modul është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës. Modulet klasifikohen në dy grupe kryesore: module të detyruara dhe module me zgjedhje.

Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e punëve laboratorike, mbrojtja

e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtja e temave të diplomave, etj.

Neni 40

Organizimi i procesit mësimor

Në fillim të vitit të ri akademik/semestrit, departamenti përgatit dhe bën publike;

- ✓ Struktura mësimore për programin e studimit, në të cilën përcaktohet ecuria e elementëve që përbëjnë këtë strukturë (mësimi, praktika, sezoni i provimeve dhe diplomave, pushimet);
- ✓ Orarin e mësimit, i cili hartohet në përputhje me planin mësimor, grupet mësimore, numrin dhe kapacitetin e auditorëve duke synuar që të ketë një shpërndarje të ekuilibruar të ngarkesës ditore në auditor të studentit.

Neni 41

Kurset dhe grupet mësimore

Mësimi zhvillohet mbi bazë grupi dhe kursi. Grupi përbën njësinë bazë të organizimit dhe zhvillimit të procesit mësimor me të cilin realizohen format e mësimit të tilla si: seminarët, punët praktike, laboratorët, ushtrimet, etj. Një grup mësimor nuk mund të ketë më shumë se **30** dhe jo më pak se **15** studentë.

Kursi përbëhet nga disa grupe mësimore (për një vit mësimor), me të cilët zhvillohen vetëm leksionet në module me programe të njëjta.

Ndarja e studenteve në grupe bëhet nga sekretaria mësimore dhe fiksohet në regjistrat e vitit akademik.

Në fillim të çdo viti të ri akademik, ZSS përmes sistemit ESSE3 bën kalimin e studentëve në vitet pasardhëse, nëse ata kanë fituar numrin minimal të krediteve të përcaktuar në këtë rregullore, në vendimet e Senatit Akademik, si dhe paguajnë tarifën e shkollimit brenda afateve të përcaktuara në fillim të çdo viti akademik.

Neni 42

Zhvillimi i mësimit

Koha, auditori ku zhvillohet mësimi, si dhe pedagogët që zhvillojnë modulën përcaktohen në

orarin, e hartuar nga **zëvendësdekani për mësimin dhe kurrikulat** në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit. Orari hartohet në fillim të çdo semestri dhe shpallet për çdo departament, **një javë para fillimit të semestrit**.

Orari ndërtohet mbi kritere metodike dhe pedagogjike, duke mbajtur parasysh harmonizimin e formave të ndryshme të mësimin (leksion, seminar/ ushtrime, laboratorë, etj) të moduleve të ndryshme dhe shpërndarjen racionale të ngarkesës së studentit. Ndryshimet në orar bëhen **vetëm me miratim të zv.dekanit për mësimin**, me kërkesë të përgjegjës të departamentit.

Kohëzgjatja e orës mësimore është **50 minuta**. Në ditët e festave zyrtare, si rregull nuk zhvillohet mësim ose provim.

Neni 43

Pjesëmarrja e studentëve në mësim

Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies (leksione, seminare, ushtrime, punë laboratorike) të moduleve të përcaktuara në planin mësimor në masën:

✓ Leksionet	80%
✓ Seminare/Ushtrime	80%
✓ Laboratorë	100 %
✓ Praktika	80%

Kur studenti me ose pa arsye nuk frekuenton masën e përcaktuar të modulit përkatës, sipas përkatës, ai shpallet i paklasifikuar (nuk fiton) dhe nuk lejohet të shlyejë detyrimet e këtij moduli. Ai është i detyruar të ri-frekuentojë modulin në vitin akademik pasardhës me të njëjtat rregulla të frekuentimit.

Pjesëmarrja e studentit evidentohet rregullisht dhe kontrollohet nëpërmjet regjistrit të pedagogut.

Neni 44

Regjistri i pedagogut

Regjistri i pedagogut është i vetmi dokument shtetëror bazë për të evidentuar zhvillimin e mësimin dhe evidentimin e mungesave. Regjistri i pedagogut është dokumenti zyrtar për llogaritjen e ngarkesës mësimore faktike të pedagogëve si dhe vlerësimet vjetore të studentëve. Regjistri i pedagogut **kontrollohet dhe vërtetohet nga përgjegjësi i departamentit**. Regjistri tërhiqet me firmë nga pedagogu pranë ZSS dhe kur mbaron, dorëzohet, gjithashtu, me firmë

pranë ZSS.

Neni 45

Sistemi i vlerësimit

Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Notat nga pesë deri në dhjetë janë nota kaluese.

Në të gjitha format e kontrollit të nohurive përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, ku vlera përkatëse detyrimisht konvertohet në notë, si më poshtë:

Niveli total i pikëve	NOTA
0 – 44 pikë	4
45 – 54 pikë	5
55 – 64 pikë	6
65 – 74 pikë	7
75 – 84 pikë	8
85 – 94 pikë	9
95 – 100 pikë	10

Neni 46

Format e vlerësimit

Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: **vlerësimi i vazhduar gjatë vitit** për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe **vlerësimi përfundimtar**. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqëson **40%** të vlerësimit total.

Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit dhe miratohet para fillimit të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit.

Neni 47

Format e kontrollit te dijeve

Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: **testimi i ndërmjetëm/detyrat** e kontrollit dhe **provimi final**. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Detyrat e ndërmjetme të kontrollit organizohen **në javën e shtatë/tetë të çdo semestri**, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetëm me shkrim.

Provimi **final organizohet**: a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar (me shkrim dhe me gojë).

Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.

Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.

Provimi final organizohet dhe përfundon në datën dhe orarin e përcaktuar në grafikun e provimeve. Grafiku i provimeve hartohet nga Zv. Dekani për mësimin në bashkëpunim me përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen jo më vonë se katër javë para fillimit të sezonit.

Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit **jo më vonë se 2 (dy) ditë përpara zhvillimit të provimit**. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërrimi i tezës.

Neni 48

Kushtet për hyrje në provim

Studenti fiton të drejtën e hyrjes në provimin e modulit kur:

- ✓ ka plotësuar kriteret detyruese të parashikuara në programin e modulit (detyrat, projektet) me mirëkuptimin dhe dakordësinë e titullarit të modulit;
- ✓ plotëson kushtet që lidhen me frekuentimin e formave mësimore;
- ✓ ka paguar tarifën e shkollimit sipas përcaktimeve të miratuara nga strukturat drejtuese të universitetit.

Vlerësimet negative (**nuk fiton**) në projektet dhe detyrat e kursit të parashikuara në programin e modulit janë penguese për hyrjen e studentit në provimin final.

Pikët e grumbullura për elementët e tjerë të mësimit (pjesëmarrje, testi ndërmjetës/detyrat e kontrollit) gjatë vitit **nuk janë penguese** për futjen e studentëve në provimin final. **Ato merren në konsideratë vetëm në vlerësimin përfundimtar të studentit.**

Pedagogu i modulit i komunikon studentit të drejtën e hyrjes ose jo në provimin final dhe nivelin e pikëve **në orën e fundit të mësimit.**

Studentët që kanë humbur të drejtën e hyrjes në provim në sezonin normal për shkak të mos realizimit të detyrës apo projektit të kursit kanë të drejtë të bëjnë shlyerjet e tyre në javën e parë të muajit shtator dhe të futen në provim në sezonin e vjeshtës.

Pikët e vlerësimit gjatë vitit hidhen në sistemin ESSE3 dhe historiku i tyre ruhet nga sistemi dhe duhet të konsiderohen nga pedagogu **edhe për sezonet e tjera për efekt vlerësimi në rastet kur studenti është ngelës në sezonin normal të modulit.**

Neni 49

Sezonet e Provimeve

Provimet zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik.

Provimet organizohen në **5 (pesë) sezone:**

- ✓ sezoni i provimeve të dimrit, i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të parë;
- ✓ sezoni i provimeve të verës, i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të dytë;
- ✓ sezoni i provimeve të vjeshtës, i cili zhvillohet në muajin shtator;
- ✓ sezoni plotësues: **java e parë e muajit janar** dhe;
- ✓ sezoni plotësues: **java e fundit e muajit prill**

Studenti, nuk lejohet të hyjë më shumë se një herë në provimin e një moduli brenda një sezoni.

Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në module të ndryshme.

Neni 50

Organizimi i Provimeve

Provimet zhvillohen në datën, auditorin dhe orën e caktuar, të cilat reflektohen në grafikun e provimeve, të shpallur katër javë para fillimit të sezonit. Në raste të jashtëzakonshme, për arsye madhore, në pamundësi të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, dekani me urdhër me shkrim e

anullon dhe cakton një datë të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve. Për çdo vendim të tillë Dekani njofton rektoratin. Provimet organizohen mbi bazë kursi ose grupi mësimor.

Neni 51

Komisionet e provimeve

Komisioni i provimit përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me **Zv.dekanin për mësimin dhe miratohet nga Dekani i fakultetit**. Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, ose kur përgjegjësi i departamentit nuk e sheh të arsyeshme, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë. **Në rast pamundësie zëvendësimi**, me propozim të Dekanit dhe miratim të Rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve nga përfundimi i tij.

Neni 52

Zhvillimi i provimit

Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit të universitetit, **me përjashtim të drejtuesit të departamentit**, dhe personave të tjerë të **autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për të kryer monitorim/ kontroll**.

Studenti nuk lejohet të futet në provim nëse nuk disponon një nga mjetet e mëposhtme të identifikimit: librezën e studentit/ kartën e studentit/ kartën e indentitetit.

Gjatë provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse, **por në asnjë rast i celularëve**. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme përjashtohet nga provimi. Provimet me shkrim zgjasin jo më pak se 2, por jo shumë se 3 orë. **Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit, apo kursit përkatës.**

Neni 53

Ndërprerja e zhvillimit të provimit

Provimi ndërpritet kur studenti kërkon t'i imponohet, ose të kërcënojë me forma të ndryshme anëtarët e komisionit. Kur ndaj anëtarëve të komisionit të provimit ushtrohet dhunë nga studenti (apo nga ndonjë person tjetër i porositur prej tij), kërkohet ndihma autoriteteve drejtuese të departamentit dhe fakultetit dhe nëse është e nevojshme deri tek organet e ruajtjes së rendit

publik për rivendosjen e kushteve normale të zhvillimit të provimit.

Neni 54

Shpallja e rezultateve të provimit

Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 (tete) ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë. *Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit.*

Pas shpalljes së rezultateve dhe hedhjes së tyre në sistem, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose të kundërshtojë rezultatin brenda dy ditëve (48 orë).

Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem brenda dy ditëve.

Në rastet e hedhjes së gabuar të notave/notës nga ana e komisionit, në lidhje me vlerësimin e studentit, komisioni ka detyrimin të verifikojë dhe bëjë korrektimin vetëm brenda kohës prej 12 ditësh. Mbas rezultati është hedhur dhe pranuar në sistem dhe ka kaluar afati kohor i 12 ditëve (nga dita e provimit), sistemi mbyllet dhe komisioni nuk ka më të drejtë të bëjë ndryshim.

Në raste të jashtëzakonshme mbas këtij afati kohor (12 ditëve), komisioni i paraqet një kërkesë me shkrim përgjegjësit të departamentit ku zhvillohet moduli për ndryshimin e notës së pretenduar dhe me miratimin e Dekanit të fakultetit korrigjohet nota në sistem nga specialisti përgjegjës i IT të universitetit i cili depoziton praktikën dokumentare tek ZSS. Procesverbali i korrigjuar arshivohet në ZSS.

Mbas hedhjes përfundimtare në sistem të notave, komisioni printon pasqyrën përfundimtare të rezultateve të provimit, i plotëson me firmat e nevojshme (komisionit, përgjegjësit të departamentit/dekanit) dhe e dorëzon tek sekretarja e departamentite cila më tej i dorëzon në ZSS.

Studenti merr vlerësimin kalues në një modul kur:

- ✓ ka plotësuar të gjitha parakushtet e përcaktuara sipas programit mësimor;
- ✓ vlerësohet me notë kaluese sipas formës së kontrollit që parashikon programi.

Studenti, që për çfarëdo arsye nuk paraqitet në provimin e një moduli, humbet të drejtën e provimit dhe konsiderohet mbetës për atë modul në atë sezon. Gjithashtu, studenti vlerësohet mbetës kur:

- ✓ nuk është i përgatitur (është vlerësuar negativisht);
- ✓ tërhiqet nga provimi;
- ✓ kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi);
- ✓ pengon zhvillimin e rregullt të provimit (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi);

Provimet me shkrim të studentëve ruhen nga pedagogu i modulit për një periudhë 6 (gjashtë) mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve.

Neni 55

Ankimimi

Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. **Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 2 ditëve (48 orëve) pas shpalljes së rezultatit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit.**

Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjës të departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. **Ky vendim është i formës së prerë.** Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjës të departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, **por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve.** Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marë regjistrohen **në regjistrin e ankesave të studentëve** që mbahet në dekanat.

Neni 56

Përmirësimi i notave

Studenti ka të drejtë të përmirësojë çdo vit mësimor vetëm **dy nota** në modulet e atij viti.

Kërkesa për përmirësim note i paraqitet Dekanit dhe ai i përcjell tek përgjegjësi i ZSS para sezonit të vjeshtës. Kërkesa për përmirësim note i paraqitet Dekanit **jo më vonë se një javë para fillimit të sezonit të vjeshtës**. Në bazë të vendimit që merr Dekani, sekretaria mësimore kryen veprimet përkatëse.

Për përmirësimin e notës, studenti provohet vetëm një herë dhe vetëm në sezonin e vjeshtës. **Mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund**. Studenti mund të përmirësojë vetëm vlerësimin e marrë në provimin final, i cili i bashkëngjitet vlerësimit të marrë në elementët e tjerë të modulit përgjatë vitit shkollor.

Neni 57

Ndërprerja e studimeve dhe largimi

Studentit mund t'i jepet leje për ndërprerjen e përkohshme të studimeve në çdo kohë të vitit. Ndërprerja e studimeve **deri në tre vjet** bëhet me lejen e Dekanit. Ndërprerja e studimeve **mbi tre vjet** bëhet me miratimin e Rektorit. Ndërprerja e studimeve fillon që ngamomenti i miratimit të lejes nga Dekani, ose Rektori. Studenti është i detyruar të respektojë këtë afat.

Ndërprerja e studimeve bëhet mbi bazën e një kërkesë të argumentuar të studentit dhe vetëm në këto raste:

- ✓ kur sëmuret për periudha të gjata;
- ✓ kur në raste fatkeqësish mbetet kryefamiljar, apo për kushte të vështira ekonomike;
- ✓ kur detyrohet të punësohet jashtë vendit për arsye të forta ekonomike;
- ✓ kur ndjek studime e kualifikime në institucione të tjera të arsimit të lartë vendas ose të huaj.

Ndërprerja e studimeve **me miratimin** përkatës është e justifikuar dhe **nuk llogaritet në kohën e rregullt të studimeve**.

Ndërprerja e studimeve **pa miratimin** përkatës konsiderohet e pajustificuar dhe është e njëjtë me mosparaqitjen e studentit në procesin mësimor, ku çdo vit i kësaj mosparaqitjeje **njësohet me vitin përsëritës**.

Rikthimi i studentit, pas ndërprerjes së justifikuar të studimeve, bëhet në fillim të çdo semestri ose në kohën kur ai ka ndërprerë studimet, por jo më vonë se dy javë nga këto afate. Studentit i njihen të gjitha detyrimet mësimore të likujduara në vitin që është shkëputur. **Në të njëjtën kohë, ai i nënshtrohet të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ndryshimet në kurrikula dhe në**

planin mësimor të vitit vijues.

Studenti mund të largohet nga universiteti, duke u çregjistruar përfundimisht. Për këtë ai bën një kërkesë me shkrim ku shpreh arsyet e largimit. Sekretaria mësimore pranon kërkesën dhe ia paraqet Dekanit të fakultetit për të marrë vendimin. **Me marrjen e vendimit, sekretaria mësimore bën çregjistrimin e studentit, duke regjistruar në regjistrin themeltar datën e çregjistrimit dhe firmën e studentit. Studenti tërheq dokumentat e tij.**

Çregjistrimi i studentit bëhet me vullnetin e tij të lirë (*përveç rasteve të përjashtimit nga shkolla*), në prani të studentit. **Dokumentat origjinale i dorëzohen studentit.**

Neni 58

Regjistrimi i studentit

Kandidati që ka fituar të drejtën për të ndjekur studimet në vitin akademik për të cilin ka konkuruar duhet të regjistrohet në sekretarinë mësimore brenda afatit të përcaktuar në udhëzimet e MASR, në të kundërt ai humbet të drejtën e regjistrimit.

Për t'u regjistruar në sekretarinë mësimore studentit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar sipas udhëzimeve të MASR dhe përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Kandidati është i detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Në momentin e regjistrimit kandidati është i detyruar të plotësojë *Kartën e Regjistrimit të Studentit*, një kopje të së cilës ai e merr me vete.

Kandidati fiton statusin e studentit pasi është regjistruar në sekretarinë mësimore, ka plotësuar dhe disponon Kartën e tij të Regjistrimit, Librezën e Studentit, si dhe ka paguar tarifën e shkollimit sipas ligjit. **Regjistrimi i kandidatit të shpallur fitues nga sekretaria mësimore përbën aktin e vetëm administrativ që i njeh atij të drejtën e të qenit anëtar i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe të fitojë statusin e studentit.**

Neni 59

Konfirmimi i regjistrimit

Në fillim të çdo viti akademik studenti është i detyruar të regjistrohet në sekretarinë mësimore (ZSS) për vitin në vazhdim brenda muajit tetor dhe të paguajë tarifën e përcaktuar përpara fillimit të sezonit dimëror të provimeve, në janar. Nëse nuk likuidon detyrimin para sezonit të provimeve të dimrit, studenti nuk lejohet të hyjë në provim.

Neni 60

Libreza e studentit

Çdo student pajiset me “*Librezën e Studentit*“, në të cilën vendoset fotografia që vulozet, gjithashtu shënohen viti i lindjes, vendlindja, numri i regjistrimit, fusha e studimeve dhe data e pranimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit të UBT. Libreza e studentit është dokument personal që evidenton rezultatet e tij në vite. Studenti e përdor atë për të vërtetuar statusin e tij, si dhe për të shfrytëzuar kushtet lehtësuese me karakter social që parashikon legjislacioni në fuqi për studentët.

Neni 61

Fitimi i statusit të studentit, përfundimi dhe heqja e tij

Një person fiton statusin e studentit **me regjistrimin** tij në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit. Statusi i studentit përfundon me **marrjen e diplomës** ose certifikatave përkatëse.

Statusi hiqet **më parë** me çregjistrimin në këto raste:

- ✓ me kërkesë të studentit për çregjistrim (largim);
- ✓ kur vërtetohet se i kanë munguar, ose ka humbur kushtet dhe kriteret për të drejtën e studimit;
- ✓ kur dënohet me burgim për një krim të rëndë, me dashje ose nga pakujdesia;
- ✓ për shkelje të rëndë ose të përsëritur rregullores së departamentit ku vazhdon studimet.

Vendimin për çregjistrimin në të gjitha rastet e merr Dekani i Fakultetit.

Studenti pajiset me dokumentet e nevojshme që vërtetojnë shlyerjen e detyrimeve deri ditën e çregjistrimit.

Neni 62

Shkëputja e studentit nga programi

Studentët që lëvizin në kuadrin e programit Erasmus Plus ose programeve të tjera ku FBM është palë, kanë status të veçantë dhe lirohen nga detyrimet e kësaj rregulloreje për frekuentimin. **Studentëve u njihen provimet e dhëna jashtë shtetit për lëndët e ngjashme, kur programet janë të barasvlershme.** Kur kthehen në fakultet, duhet të shlyejnë detyrimet për lëndët e tjera, të cilat **nuk duhet të kalojnë masën e 50% të detyrimeve vjetore të planit ekzistues mësimor.** Për raste të veçanta, çështja shqyrtohet në Dekanat. Likuidimi i detyrimeve mësimore bëhet me plan individual, të hartuar nga departamenti dhe të miratuar nga Dekani i Fakultetit.

Neni 63

Afatet për ndryshimin dhe saktësimin e gjeneraliteteve të studentit

ZKS-të e fakulteteve kanë detyrimin të mbledhin të dhënat e sakta të studentëve, përpara plotësimit të dokumentit të diplomës, çertifikatës ose dëshmisë. Studenti duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për ndryshimin dhe saktësimin e gjeneraliteteve dhe të dhënave të tjera, para plotësimit të dokumentit të diplomës, çertifikatës ose dëshmisë. Në rast ndryshimi të gjeneraliteteve (emër, mbiemër) dokumenti për ndryshimin e tyre duhet të paraqitet jo më vonë se data e provimit të fundit të sezonit në të cilin zhvillohet diplomimi. Në një rast të tillë, në diplomë do të pasqyrohet në kllapa edhe gjeneraliteti i mëparshëm, që është kërkuar të ndryshohet.

Neni 64

Të drejtat dhe detyrimet e studentit

Studenti ka të drejtë:

- Të përdorë, sipas rregullave përkatëse, të gjitha mundësitë dhe pajisjet që ofron shkolla për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive, kulturore etj;
- Të marrë pjesë në zgjedhje dhe të përfaqësohet në organet drejtuese si në Senatin Akademik të Universitetit, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e UBT-

së, si dhe rregulloret përkatëse të këtyre organeve;

- Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse;
- Të përfitoje bursë studimi brenda ose jashtë shtetit, kur plotëson kushtet e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, të Senatit dhe në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare;
- Të përfitojë shpërblime të veçanta që administrohen dhe akordohen nga Universiteti sipas kritereve të caktuara nga Senati;
- Të strehohet në konvikte që ofron Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve të Universitetit, nëse nuk ka mundësi tjetër strehimi;
- Të ndjekë studimet në një degë të dytë, sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe vendimet e Senatit që rrjedhin nga aktet e posaçme të MASR-së.
- Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit;
- Të njihet me planet mësimore të moduleve përkatëse. Sekretaria mësimore bën afishimin e tyre në stendat e fakultetit. Planet mësimore publikohen edhe në faqen e internetit të fakultetit. Ato mund të kërkohen edhe pranë zyrës së informimit dhe orientimit të studentëve;
- Të njihet me detyrimet semestrale dhe vjetore nëpërmjet planit mësimor të afishuar;

Studenti është i detyruar:

- Të ndjekë leksionet, seminarët dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij
- Të njohë me hollësi rregullat e shkollës dhe detyrimet e tij, të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre. Në të kundërt shkolla nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
- Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit, nga kjo rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor;
- Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe programet e moduleve;

- Të zhdëmtojë, sipas rregullave në fuqi, të gjitha dëmtimet e vlerave materiale të kryera prej tij;
- Të respektojë Kodin e Etikës të UBT-së dhe të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit;
- Të shlyejë të gjitha detyrimet financiare si dhe ato akademike përpara fillimit të provimit;
- Të respektojë të gjitha rregullat që lidhen me procesin mësimor dhe ato të zhvillimit të provimit.

Neni 65

Veprime të ndaluara

Shkelje të rregullave të shkollës konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit, që çenojnë personalitetin e pedagogut apo të çdo punonjësi tjetër të shkollës; normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme zyrtare etj., aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj. Këto veprime konsiderohen shkelje të rregullave të shkollës, kur nuk mbartin elementë të veprës penale.

Ndaj studentit që kryen këto veprime merren këto masa disiplinore:

- I. **këshillim,**
- II. **vërejtje me shkrim,**
- III. **përjashtim nga shkolla për një vit,**
- IV. **përjashtim nga Universiteti (heqje e së drejtës të studimit të fituar).**

Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr **Dekani i Fakultetit me propozim të Komisionit të Etikës së fakultetit.**

Kundër vendimit të Dekanit për përjashtim një vit nga shkolla, studenti ka të drejtë të ankohet tek Rektori.

Vendimin për përjashtimin nga Universiteti (heqja vetëm e së drejtës së studimit) e merr Rektori i Universitetit mbi bazën e propozimit të dekanit.

Kundër vendimit të Rektorit për çregjistrim, studenti mund të ankohet në gjykatë. Masat disiplinore pasqyrohen në regjistrin e studentëve. Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e një muaji për këshillimin, brenda tre muajve për vërejtjen dhe një viti për pezullimin.

Neni 66

Veprimtaria jashtë mësimore

Studentët kryejnë veprimtari jashtë mësimore me karakter kulturor, shkencor, sportiv e zbavitës, në vende, kohë dhe përmbajtje të lejueshme.

Veprimtari të tilla nga studentët e një fakulteti në ambjentet e fakultetit mund të kryhen vetëm me lejen e autoritetit drejtues përkatës, ndërsa në nivel universiteti me leje të Rektorit. Aktivitete me karakter demonstrativ ose proteste lejohen vetëm me leje nga Rektori, me kërkesë të shoqatave të tyre, të njohura ligjërisht.

Neni 67

Këshillat e studentëve

Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore, institucioni të arsimit të lartë, si edhe në nivel kombëtar. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.

Neni 68

Karta e studentit

Studentët e institucioneve publike e private të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara. MASR përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin dhe shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë ose njësisë të qeverisjes vendore që mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në

marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme

Neni 69

Të drejtat dhe detyrat e stafit akademik dhe të atij ndihmës-mësimit

Stafi akademik dhe ai ndihmës-mësimit kanë të drejtë:

- Të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë ekzistuese në universitet, fakultet e departament, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
- Në funksion të zhvillimit të programit të modulit, pedagogu ka të drejtë të përdorë forma sa më të larmishme në mësimdhënie, me qëllim që të mundësojë arritjen e objektivave të përcaktuara;
- Të kërkojë nga studentët respektimin e kërkesave të ligjit, statutit dhe rregulloreve të shkollës, duke mos lejuar, në asnjë rast, shkeljen e tyre;
- Të kërkojë nga studentët një frymë etiko-morale të tillë, që të jetë në pajtueshmëri me traditën si edhe me legjislacionin tonë në fuqi;
- Kërkesat që shtrohen gjatë procesit mësimit respektohen dhe zbatohen pa diskutim nga të gjithë. Ato mund të kontestohen në organet drejtuese të departamentit, fakultetit apo universitetit, vetëm jashtë procesit të mësimit;
- Të kërkojë nga organet drejtuese të departamentit, fakultetit dhe universitetit respektimin prej tyre të të gjitha të drejtave që u siguron atyre Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

Detyrat e stafit akademik dhe të atij ndihmës-mësimit janë:

- Pedagogu harton në kohën e duhur programin mësimit të modulit dhe në përputhje me të, planin kalendar. Një kopje të tyre ai e dorëzon në departament;
- Të zhvillojnë aktivitetin mësimit, duke zbatuar me përpikëri orarin e hartuar nga departamenti. Moszbatimi i orarit nuk justifikohet për asnjë arsye, **me përjashtim të rasteve të miratuara nga Dekani i Fakultetit**. Në këtë rast departamenti merr masa për

zëvendësimin e tij;

- Të shfrytëzojnë me efektivitet orën mësimore, duke bërë përpjekje për ta justifikuar sa më mirë atë. **Nuk lejohet, për asnjë arsye, fillimi me vonesë dhe përfundimi para kohe i orës së mësimi.** Pedagogu duhet të bëjë përpjekje për ndjekjen sistematike të zhvillimit dhe të arritjeve të shkencës përkatëse në plan kombëtar e botëror dhe ta reflektojë atë në procesin mësimor;
- Pedagogu harton në kohën e duhur tezat e provimit dhe i firmos ato tek përgjegjësi i departamentit. **Çdo vit tezat e provimit (testimit) duhet të jenë të riformuluara dhe të përditësuara;**
- Në fillim të vitit akademik pedagogu u bën të qartë studentëve vendin, natyrën, shtrirjen, detyrimet dhe mënyrën e likuidimit të modulit përkatës, në përputhje me planin dhe programet mësimore në fuqi, duke u treguar atyre qartësisht edhe mënyrën e sigurimit të literaturës (tekst në shitje, leksione të shumëfishuara, shënime në klasë, literaturë e huaj etj);
- Kanë të drejtë të udhëheqin dhe mbikqyrin teza për diplomën “Master i Shkencave” të gjithë pedagogët me shkallë kualifikimi më shumë se “Doktor”.
- Udhëheqësi i tezave të diplomës “Master i Shkencave” nuk mbikqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar.
- Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë, ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore;
- Të respektojnë të gjitha hallkat e procesit mësimor, kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit si dhe të rregulloreve të universitetit dhe fakulteteve që kanë të bëjnë me procesin mësimor;
- Të respektojnë gjatë gjithë veprimtarisë së tyre parimet e etikës qytetare, duke shfaqur një figurë morale të papajtueshme me veset e këqija. Figura e pedagogut duhet të shërbejë për studentët si shembull i ndershmërisë, largpamesise etj.
- Pedagogu mban përgjegjësi për shkeljen e rregullave të shkollës. Shkelje të rregullave të shkollës konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e pedagogut që çenojnë personalitetin e studentëve apo të punonjësve të tjerë të Universitetit, normat etiko-

morale të mjedisit universitar apo shoqërisë.

Ndaj pedagogut që kryen veprime të tilla do të merren këto masa disiplinore:

- Vërejtje me shkrim;
- Paralajmërim për përjashtim nga puna;
- Përjashtim nga puna;

Pedagogu konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e 6 muajve për vërejtjen me shkrim dhe brenda 1(nje) viti për masën paralajmërim për përjashtim nga puna.

Neni 70

Kjo Rregullore shtrin veprimtarinë, duke filluar nga viti akademik 2020 – 2021.


Neni 71

Të drejtën e patjetërsueshme për interpretimin e kësaj Rregulloreje e ka Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit.

Pergatiti

Pergjegjësi i Departamentit të Akuakulturës dhe Peshkimit

Prof. Asoc. Dr. Rigers BAKU



Qershor 2021